


## Kush e organizon hedhjen dhe riciklimin e baterive?

### Grupi i interesit për hedhjen e baterive INOBAT

INOBAT mbledh tarifën e parashikuar për hedhjen e baterive, për llogari të Zyrës Federale për Mjedisin (BAFU). Në këtë mënyrë, ai financon dhe organizon grumbullimin, transportin dhe riciklimin e baterive të përdorura, si dhe masat informuese për bizneset dhe popullsinë.

### Riciklimi i baterive në Alpet e Bernës

Të gjithë akumulatorët dhe bateritë e përdorura të pajisjeve në Zvicër grumbullohen te kompania „Batrec“ në Wimmis. Këtu bateritë riciklohen në një impiant nga më modernët dhe më efikasët në botë. Metalet e përfutuara përdoren kryesisht në industrinë e ndërtimit. Për shembull, nga mangani i çelikut krijohen pjesët e derdhura ose kapakët e kanalizimeve. Zinku përdoret për të bërë të pandryshkshme pjesët prej hekuri, si parrakët anësorë ose trarët mbajtës prej çeliku.



Më shumë informacione për riciklimin e baterive në Zvicër gjeni në faqen e internetit [www.inobat.ch](http://www.inobat.ch) ose direkt te ne:

#### INOBAT

Batterierecycling Schweiz  
Postfach 1023  
3000 Bern 14

**Bateritë  
duhet të kthehen mbrapsht**

[www.inobat.ch](http://www.inobat.ch)



## Informacione të rëndësishme për riciklimin e baterive

30 milionë bateri hidhen çdo vit në plehra.

Kthejini ato mbrapsht.

## Bateritë dhe akumulatorët janë tendencë

Kurrë më parë nuk ka pasur në përdorim kaq shumë bateri dhe akumulatorë sa në ditët e sotme. Ato gjenden te biçikletat elektrike, telefonat celularë, tabletat ose laptopët. Por edhe te veglat e punës, orët dhe sigurisht tek telekomandat. Dy gjëra kanë të përbashkëta të gjitha bateritë dhe akumulatorët: nuk rrojnë përgjithmonë dhe në fund të jetëgjatësisë duhen kthyer dhe ricikluar.



## Përse duhet t'i ricikloj bateritë?

### Sëpe ky veprim mbron mjedisin dhe kursen burimet

Në pjesën më të madhe të tyre, akumulatorët dhe bateritë e përdorura përbëhen nga materiale që mund të ripërdoren. Këto materiale të ripërdorshme përfitohen nga procesi i riciklimit dhe kështu nuk duhet të shpërbëhen në natyrë. Në të njëjtën kohë edhe mjedisi mbrohet nga depozitimi i metaleve të rënda.

### Sëpe bateritë janë mbetje të rrezikshme

Në Zvicër, bateritë e përdorura klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Të gjithë konsumatorët e kanë detyrim ligjor që t'i kthejnë bateritë e përdorura në pikën e blerjes së tyre ose në një pikë tjetër grumbullimi.



## Si dhe ku mund t'i hedh bateritë?

### Pikat e shitjes pranojnë kthimin e baterive dhe të akumulatorëve

Në Zvicër të gjitha pikat e shitjes dhe dyqanet kanë detyrim ligjor që të pranojnë bateritë e kthyer. Në përgjithësi, bateritë dhe akumulatorët mund të kthehen falas në vendet ku shiten – pavarësisht se ku i keni blerë bateritë tuaja. Si rezultat, vetëm në Zvicër ka mbi 11 000 pika grumbullimi që variojnë nga dyqanet e shitjes me pakicë te dyqanet e specializuara dhe magazinat e mëdha e deri te zyrat e postës, kioskat dhe pikat e furnizimit me karburant. Shihni për pajisjet përkatëse ose për kutitë e grumbullimit INOBAT ose pyetni pranë personelit të shitjes.



Kutitë praktike të grumbullimit mund t'i porositni në adresën [www.inobat.ch](http://www.inobat.ch).

### Komunat i mbledhin në mënyrë të përqendruar

Në shumë komuna akumulatorët dhe bateritë e përdorura mund të hidhen edhe në pikat e grumbullimit publike ose private.

### Shumë ndërmarrje bashkohen vullnetarisht

Edhe kompanitë ecin përpara me shembullin pozitiv dhe vendosin pika grumbullimi në dispozicion të punonjësve.

## Sa më kushton hedhja e baterive?

### Ju keni paguar tashmë për këtë

Në çmimin e blerjes së baterive dhe akumulatorëve përfshihet edhe një tarifë e parashikuar për hedhjen e baterive (VEG). Për rrjedhojë, hedhja e mëvonshme e baterive dhe akumulatorëve ofrohet falas për ju.